

# Perceptimet & Qëndrimet e Qytetarëve në Mitrovicën Jugore & Veriore




"Perceptimet dhe Qëndrimet e Qytetarëve në Mitrovicën Jugore dhe Veriore" është përgatitur nga IKS, përkrahur nga Friedrich Ebert Stiftung.

Për më shumë raporte të ngjashme, vizitoni faqën tonë të internetit të Iniciativës Kosovare për Stabilitet, [www.iksweb.org](http://www.iksweb.org), vizitoni faqën tonë në Facebook, ose na kontaktoni direkt përmes emailit me pyetjet tuaja në [info@iksweb.org](mailto:info@iksweb.org)

## PËRMBAJTJA

PASQYRA E TABELAVE .....	3
PËRMBLEDHJE .....	1
1. KARAKTERISTIKAT E MOSTRËS DHE METODOLOGJIA .....	4
2. PUNËSIMI DHE TË ARDHURAT .....	9
3. BINDJET DHE QËNDRIMET .....	15
4. PËRCEPTIMET PËR SHTETIN DHE MIRËQENIEN .....	20
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....	23
SHTOJCA 1: RAPORTI I PËRGJITHSHËM STATISTIKOR: .....	24
Mitrovica Jugore .....	24
SHTOJCA 2: RAPORTI I PËRGJITHSHËM STATISTIKOR: .....	43
Mitrovica Veriore .....	43
SHTOJCA 3: PYETËSORI .....	60
Analiza e punës dhe punësimit .....	60
Demografia dhe statusi i punësimit .....	60



## PASQYRA E TABELAVE

Figure 1. Mosha sipas komunës dhe gjinisë.....	4
Figure 2.Gjinia .....	5
Figure 3.Statusi martesor .....	5
Figure 4.Numri i anëtarëve në familje sipas gjinisë.....	6
Figure 5.Niveli i arsimimit sipas gjinisë dhe komunës.....	6
Figure 6.Numri i anëtarëve të punësuar në familje.....	7
Figure 7.Të ardhurat familjare mujore.....	8
Figure 8.Nëse jeni i/e punësuar, Ku punoni? .....	9
Figure 9.Paga minimale për të cilën do të punonin me kohë të plotë.....	9
Figure 10.Arsyet se pse nuk kanë gjetur punë .....	10
Figure 11.Trajnimet e aftësimin profesional.....	11
Figure 12.Ndihma Sociale.....	11
Figure 13.Punësimi në sektorin publik.....	12
Figure 14.Punësimi në sektorin privat .....	13
Figure 15.Preferenca për punësim në Kosovë apo në ndonjë shtet në Evropë .....	13
Figure 16.Sa është e mundshme që në 12 muajt e ardhshëm të jeni i/e papunë dhe të kërkoni punë për të paktën 4 javë rresht? .....	15
Figure 17.Sa është e mundshme që ju të mos merrni kujdesin mjekësor që ju nevojitet nëse sëmureni gjatë 12 muajve të ardhshëm .....	16
Figure 18.Debatohet për koston e pensioneve në Kosovë. Sipas jush, cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë? .....	17
Figure 19.Për çdo 100 persona në moshë pune, sa mendoni se nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar nevojat bazike? .....	18
Figure 20.Sipas jush, pushimi i lehonisë në Kosovë është?.....	19
Figure 21.A keni marrë ndonjë shërbim shëndetësor në institucionet publike gjatë 12 muajve të fundit? .....	20
Figure 22.Sa efikas mendoni se është shërbimi publik shëndetësor në Kosovë? .....	21
Figure 23.Perceptimet mbi mjetet financiare .....	21
Figure 24.Sipas jush, sa i lartë duhet të jetë një pension mujor për të mbuluar nevojat bazë .....	22
Figure 25.Qeveria dhe taksat.....	22

## PËRMBLEDHJE

Pasqyrimi i mirëfilltë i përceptimeve, qëndrimeve dhe opinioneve të qytetarëve mbetet thelbësor në njohjen e vetëdijësimit të popullësisë karshi çështjeve sociale. Kjo për më tepër del të jetë e nevojshme në një ekonomi si Kosova, ku papunësia mbetet e lartë derisa numri i skemave sociale shkon duke u rritur. Përveç kësaj, sfidues është edhe kontributi i qytetarëve dhe vetëdijësimi i tyre kundrejt këtyre çështjeve, gjë që e vështirëson edhe më tepër dialogun social si proces që balancon interesat e palëve të përfshira, specifikisht të punëtorëve dhe punëdhënësve.

Për të siguruar një dialog shoqëror gjithpërfshirës me drejtësi dhe baraza për të gjithë, është mëse e nevojshme paraqitja e perspektivës së të gjitha palëve, duke e pasuruar kështu dialogun e vazhdueshëm shoqëror me të dhëna direkte nga terreni. Kështu, kontributi i këtij hulumtimi mbetet pikërisht nxjerrja në pah e nivelit të vetëdijësimit të qytetarëve bazuar në të dhëna empirike, më konkretisht përcjellja në mënyrë reale e qasjes në të ardhura, standardit të jetesës, shtetit të mirëqenies dhe përceptimeve të qytetarëve në këto fusha.

Si rrjedhojë, skemat e mirëfillta sociale dhe aktivizimi i fuqisë punëtore mbesin epiqendra e veprimtarisë së IKS, të reflektuara edhe në punën dhe rezultatet e arrira përgjatë historisë së organizatës tonë. Në këtë kontekst, qëllimi i këtij hulumtimi është vazhdimësi e një pune të gjatë të IKS kundrejt paraqitjes dhe analizës së gjendjes në Kosovë, me të dhëna kuantitative. Inputet e mbledhura në këtë hulumtim i shërbejnë drejtpërdrejt procesit apo thënë më mire cilësisë së një dialogu shoqëror efikas, duke ndikuar kështu në një jetesë të denjë për qytetarë e Kosovës.

Gjithëpërfshirja mbetet ajo çka e veçon këtë raport. I balancuar nga aspekti i pjesëmarrjes gjinore, për më tepër ky raport sjell risi në vetë vendin e hulumtimit pasi që përfshihen të dy pjesët e Mitroviës, ajo Jugore dhe Veriore. Përveç se një ndër hulumtimet e para që përsfshin qytetarët e Mitrovicës Veriore, veçantia mbetet në përgjigjet dhe dallimet në mes të pjesëmarrësve për çështjet sociale. Të anketuar janë 350 qytetarë, prej të cilëve 250 janë nga komuna e Mitrovicës Jugore dhe 100 nga komuna e Mitrovicës Veriore. Të

gjeturat e këtij raporti tentojnë të informojnë publikun për ndryshimin në sjelljet (perceptimet dhe qëndrimet) rreth problemeve socio-ekonomike të qytetarëve nga Mitrovica Jugore dhe Mitrovica Veriore. Për më tepër, të gjeturat mund të përmblihen se:

Ka dallime mes strukturës së familjes në mes të pjesëve, ku Mitrovica Jugore prin me familje më të madhe duke filluar nga **5 anëtarë e më shumë**, derisa Mitrovica Veriore ka familje më të vogla, që më së shumti kanë nga **4 anëtarë**.

Në Mitrovicën Jugore sektori privat mbetet punëdhënë kryesor me **34%**, ndërsa në komunën e Mitrovicës Veriore sektori publik përbën sektorin kryesor të punësimit me **43%** dhe në dallim prej pjesës tjetër, sektori privat përbën vetëm **10%**.

Papunësia mbetet e lartë në të dy pjesët, ku **14%** e qytetarëve nga Mitrovica Jugore dhe **17%** e qytetarëve nga Mitrovica Veriore nuk e kanë asnjë familjare të punësuar.

Respondentët nga Mitrovica Veriore do të punonin për pagë minimale më të lartë se ata nga Mitrovica Jugore ku **9.3%**, të respondentëve nga Mitrovica Jugore janë të gatshëm të punojnë për pagë **151-200 Euro**, ndërsa 12% e respondentëve nga Mitrovica Veriore pranojnë se **400 deri 500 Euro** duhet të jenë si pagë minimale.

Gratë e Mitrovicës Jugore kanë më së pakti stabilitet në punësim, krahasuar me gratë e Mitrovicës Veriore, por edhe me burrat e të dy pjesëve. Derisa **16.6%** e burrave e shohin si të pamundur humbjen e vendit të punës në 12 muajt e ardhshëm, njëjtë menduan vetëm **4%** e grave, kurse **18.2%** e tyre prisnin të humbin vendin e tyre të punës në 12 muajt e ardhshëm.

Si rrjedhojë, në Mitrovicën e Veriut qëndrueshmëria në punësim për vitin pasues është e mjaft e lartë si për burrat dhe për gratë. **27%** e burrave dhe **21%** e grave besojnë që nuk do të humbin vendin e punës në 12 muajt e ardhshëm.

**57%** e respondentëve nga Mitrovica Jugore konsiderojnë që **201-300 Euro** janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e tyre, derisa **30%** dhe **25%** e respondentëve nga komuna Veriore konsiderojnë kategorinë 301-400 Euro dhe 401-500 Euro, si një pension të denjë për të përmbushur nevojat.

Rreth **49%** e të anketuarve nga Mitrovica Jugore mendojnë që Kosova do të jetë në gjendje të rrisë nivelin e pensioneve, të cilin pohim e besojnë vetëm 9% e të anketuarve nga Mitrovica Veriore.

Kohëzgjatja prej **1 viti** e pushimit të lehonisë konsiderohet si e mjaftueshme për qytetarët e Mitrovicës Jugore, derisa për ata të Mitrovicës Veriore konsiderohet si periudhë e shkurtër.

# 1. KARAKTERISTIKAT E MOSTRËS DHE METODOLOGJIA

Ky hulumtim i fokusuar në Mitrovicën Jugore dhe atë Veriore, ka një strukturë të larmishme moshore të respondentëve, që varion nga 18 deri 65+ vjeç. Hulumtimi është kryer me anë të një pyetësoi, në të cilin morrën pjesë 350 qytetarë, prej të cilëve 250 janë nga komuna e Mitrovicës Jugore dhe 100 nga komuna e Mitrovicës Veriore. Metoda e përzgjedhjes së mostrës, është zhvilluar me metodologjinë e rastit. Sa i përket përbërjes demografike të mostrës, në Mitrovicën Veriore dominon moshja e mesme, gjersa në Mitrovicën Jugore struktura e moshës është relativisht më e re. Siç shihet në Figurën 1, te moshat më të reja, nga 18-25 vjeç, në Mitrovicën Jugore dominon gjinia femërore, ndërsa në Mitrovicën e Veriut gratë respondentë janë nga moshja 26-35 vjeçe. Nga struktura demografike e përfshirë në këtë hulumtim, duket që ka një disbalancë gjinor të theksuar në moshën 46-55 vjet në komunën veriore, gjersa në atë të jugut nuk vërehet ndonjë disbalancë e theksuar. Sa i përket moshës së respondentëve: në Mitrovicën e Jugut dominojnë moshat nga 26 deri 45 vjeç, gjersa në atë veriore dominojnë moshat mbi 35 deri në 55 vjeç.




Figure 1. Moshë sipas komunës dhe gjinisë

Reprezentimi gjinor i është përshtatur asaj që njihet si mostër e disponueshme. Struktura gjinore ka sjellë një përfaqësim thuajse të ngjashëm në të dy komunat, madje përfaqësimi i grave në hulumtim është thuajse identik në dy komunat. Nga 250 respondentë në Mitrovicën e Jugut, 62% janë burra dhe 38% gra. Po ashtu në Mitrovicën

Veriore, 61% janë burra dhe 39% gra. Pra, ka një diferencë të konsiderueshme mes gatishmërisë së burrave dhe grave për përfshirje në hulumtim.




Figure 2.Gjinia

Në Mitrovicën Veriore vërehet një numër më i madh i personave, partnerët e të cilëve kanë ndërruar jetë. Kjo kategori përbën 10%. Madje, në këtë komunë vërehet edhe një trend më i madh i divorceve, që përfshin 5% të totalit.




Figure 3.Statusi martesor

Në kontekstin e familjes, vërehen dy tendenca të ndryshme në raport me komunat. Në Mitrovicën Jugore dominon tipi i familjes së zgjeruar me 5 anëtarë ose më shumë, gjersa, tek Mitrovica Veriore një tendencë drejt familjes së ngushtë nga modeli i zgjeruar, pra ku dominon struktura deri me 4 anëtarë kryesisht. Mesatarja për numër të familjarëve në komunën Jugore, është 5.31 anëtarë për familje, gjersa në atë veriore 3.84 anëtarë. Prej 19% të respondentëve jetojnë në familje me nga 5 anëtarë. Duhet theksuar se maksimumi i anëtarëve të përmendur nga respondentët nga Mitrovica Veriore, janë 8 anëtarë, gjersa



nga komuna e Mitrovicës së Jugut ka familje të përbëra me nga 10-të, 12-të dhe 13-të anëtarë. Këto nuk e kalojnë 2% e participimit në mostrën e përgjithshme.




Figure 4. Numri i anëtarëve në familje sipas gjinisë

Mitrovica Veriore dominon në kategoritë me 1-3 anëtarë të familjes të punësuar, gjersa Mitrovica Jugore dominon në kategoritë 4-6 anëtarë të familjes të punësuar. Mirëpo, duhet pasur parasysh fakti se fillimisht, këtu ka ndikuar numri më i madh i mostrës. Së dyti në mirëqenie, e kjo lidhet me madhësinë e familjes. Siç u theksua edhe tek figura 4. Në Mitrovicën Jugore dominon modeli i familjes së zgjeruar, ku dallimi është afër 2 anëtarë më shumë se sa familjet që jetojnë në Veri.




Figure 5. Niveli i arsimit sipas gjinisë dhe komunës

Dallim i dukshëm mes dy komunave vërehet në nivelin e edukimit të respondentëve nga të dy komunat. Niveli më i lartë i mosmbarimit të edukimit fillor është dukshëm më i lartë në Mitrovicën Veriore, ku 7% e respondentëve nuk kanë mbaruar shkollimin fillor, gjersa kjo përqindje është 2.4% në komunën e Mitrovicës Jugore. Mosshkollimi si dukuri vërehet më shumë tek gratë se tek burrat. Në Mitrovicën Jugore pjesa dërrmuese, 43%, kanë të përfunduar së paku shkollën e mesme, ndërsa 66% në Mitrovicën Veriore kanë vetëm shkollimin fillor. Në përgjithësi, nga respondentët e anketuara, nivel me të lartë të edukimit kanë burrat se gratë.




Figure 6. Numri i anëtarëve të punësuar në familje

Sa i përket aspektit ekonomik, të dy komunat nuk duket të kenë një situatë të favorshme. Madje, është mjaft shqetësues niveli i papunësisë në të dy komunat. Një përfundim i tillë vjen nga rezultatet e hulumtimit, ku nga 250 respondentë, 14% e tyre në Mitrovicën Jugore kanë deklaruar se nuk kanë asnjë anëtar të familjes të punësuar. Edhe më shqetësuese është situata në Mitrovicën Veriore. Aty, nga rezultatet e hulumtimit, del se 17% e respondentëve nuk kanë asnjë person të punësuar në familje.

Nëse shohim në përgjithësi, niveli i mirëqenies nuk është se dallon shumë në të dy komunat. Pak më mirë qëndron Mitrovica Veriore, ndonëse numri i anëtarëve të punësuar në Jug është më i madh.





Figure 7. Të ardhurat familjare mujore

Në nivel të përgjithshëm, mund të konkludohet se të dy komunat nuk kanë nivel të lartë të zhvillimit, që reflektohet edhe në nivel të ulët të mirëqenies. Në të dy komunat, familjet me të ardhura mujore nga 401-500 Euro përbëjnë kategorinë më të shpeshtë. Në Mitrovicë Jugore 16% jetojnë në këtë prag, kurse në atë veriore 19%. Përqendrimi kryesor i familjeve është nga kategoria 201 deri në 500 Euro të të ardhurave mujore.

Gratë nga Mitrovica Veriore kanë deklaruar nivel më të lartë të të ardhurave dhe kjo ndërlidhet me mirëqenie më të mirë se sa gratë nga Mitrovica Jugore. 13% e grave në Veri jetojnë në familje me të ardhura nga 401 deri në 600 Euro, ndërsa 10.6% e grave në Mitrovicë Jugore jetojnë në këtë prag.

## 2. PUNËSIMI DHE TË ARDHURAT




Figure 8. Nëse jeni i/e punësuar, ku punoni?

Një diferencë e madh mes dy komunave shihet në sektorin e punësimit, ku ka një dallim tejet të madh mes sektorëve që ofrojnë vende pune. Në Mitrovicën Jugore sektori kryesor është ai privat me 34% , ndërsa në komunën e Mitrovicës Veriore sektori publik përbën sektorin kryesor të punësimit me 43% dhe në dallim prej pjesës tjetër, sektori privat përbën vetëm 10%. Ky trend i punësimit vlen pa dallim gjinie.




Figure 9. Paga minimale për të cilën do të punonin me kohë të plotë

Kur janë pyetur se cila do ishte paga minimale për të cilën do të punonin, respondentët nga të dy komunat kanë pasur hezitim të përgjigjen. Nga krahasimi që i bëhet të dy komunave, duket qartësisht se respondentët nga Mitrovica Veriore do të punonin për paga më të larta se ata nga Mitrovica Jugore. Nga pjesa dërrmuese që janë përgjigjur, 9.3% të

respondentëve nga Mitrovica Jugore janë të gatshëm të punojnë për pagë 151-200 Euro. Gjersa, pjesa kryesore e atyre që janë përgjigjur nga Mitrovica Veriore, 12% janë të gatshëm të punojnë për pagë nga 400 deri 500 Euro.

Në rrafshin gjinor, gratë janë të gatshme të punojnë për paga më të ulëta. Kjo tendencë gjerësisht dominon në Mitrovicën Jugore. E njëjta nuk vlen edhe në Mitrovicën Veriore, ku kategorinë kryesore 400 deri 500 Euro e dominojnë gratë. Pra, gratë nga Mitrovica Veriore dëshirojnë të punojnë për paga më të larta se sa gratë në Mitrovicën Jugore.




Figure 10. Arsyet se pse nuk kanë gjetur punë

Mungesa e lidhjeve shihet si një shkaktarët kyç për mospunësim. Sipas respondentëve nga Mitrovica Veriore, 12% e prej tyre besojnë se ky është shkaku i punësimit. Kjo mund të ndërlidhet me faktin se sektori publik në këtë komunë është gjeneratori kryesor i punësimit. Si shkak i dytë është se nuk kanë gjetur punë në profesionin e tyre, pasi 9% e qytetarëve janë të këtij mendimi.

Për këtë shkak mund të jetë fakti i moszhvillimit të komunës dhe mosposedimi i kapaciteteve të krijojnë punë. Një situatë e ngjajshme është dhe në Mitrovicën Jugore. Qytetarët konsiderojnë mungesën e lidhjeve me persona në pozitë si një nga shkaqet kryesore për mospunësim (7.3%). Mirëpo, me përqindje pothuajse të njëjtë (7%), respondentët thonë se nuk janë të vetëdijshëm për shkaqet e mospunësimit (7% prej tyre). Pra, dy arsyet kryesore sipas tyre janë mungesa e lidhjeve, por dhe pamundësia e dhënies së një arsyeje specifike se përse ata nuk kanë gjendur vend pune. Një përqindje e madhe nuk është koshiente për arsyet se pse nuk është brenda tregut të punës. Mirëpo, një përqindje pothuajse e njëjtë me atë paraprahen (6.9%) besojnë se nuk i plotësojnë

kërkesat që ka tregu, ndonjë kjo shifër nuk korrespondon me nivelin e arsimit që posedojnë.




Figure 11. Trajnimet e aftësisimit profesional

Një nga format kryesore të fitimit të aftësive të nevojshme për treg, janë edhe trajnimet. Qytetarët janë pyetur se a kanë ndjekur trajnime në qendrat e aftësisimit profesional. Në të dy komunat përqindja e atyre që kanë ndjekur trajnime është tejet e vogël, mirëpo interesim më të lartë për këto trajnime kanë qytetarët nga Mitrovica Jugore. Burrat kanë interesim më të lartë se gratë, derisa në Mitrovicën Veriore interesimi është i njëjtë. Në Mitrovicën Jugore 6.1% e burrave pohojnë se kanë ndjekur trajnime në QAP kundrejt 4.5% e grave që pohojnë të njëjtën. Kjo përqindje në Mitrovicën Veriore nuk e kalon 1% tek dy gjinitë.




Figure 12. Ndihma Sociale

Duke marrë në konsideratë faktorët socialë të sipërpërmendur mbi mirëqenien, kemi parë që në disa aspekte Mitrovica Veriore qëndron më mirë, duke pasur parasysh madhësinë e familjes dhe të ardhurat. Kjo vërehet edhe në numrin e rasteve që kërkojnë asistencë sociale. Në Mitrovicën Jugore janë gjithsej 10.6% e personave të cilët përfitojnë Ndhimë Sociale, përkundër Mitrovicës Veriore ku përfitojnë 3%. Një indikator këtu mund të jetë përfitimi nga skemat e shtetit të Serbisë. Familjet ku burrat janë kryefamiljarë janë përfitues më të mëdhenj në të dy komunat, përkundër familjeve ku gratë janë kryefamiljare. Për dallim nga Mitrovica Veriore, ku gratë përfitojnë më shumë ndihmë sociale.




Figure 13. Punësimi në sektorin publik

Mënyra e punësimit është, po ashtu, një nga çështjet më të rëndësishme të trajtuara. Është e dukshme që në të dy komunat është krijuar një opinion i përgjithshëm se lidhjet janë kriter shumë i rëndësishëm për t'u punësuar.

Qytetarët e Mitrovicës Veriore mendojnë se për t'u punësuar duhet të keni të njohur dhe të jeni kompetentë të punësoheni në sektor publik (48% kanë mendim të tillë).

Ndërkohë që në Mitrovicën Jugore, lidhjet konsiderohen si elementi kryesor për punësim (42.3% mendojnë kështu). Ndonëse, jo pak qytetarë kanë një mendim të njëjtë dhe në Mitrovicën Veriore. 32% prej tyre kanë po të njëjtin mendim si qytetarët nga pjesa veriore, që lidhjet janë i vetmi kriter i punësimit.

Një përqindje jo e vogël, 24.5%, në Mitrovicën Jugore, mendojnë po ashtu, që të jeni kompetentë është kriteriumi i punësimit. Ndërsa, në Mitrovicën Veriore ka një përqindje më të lartë të atyre që mendojnë se duhet paguar ryshfet 7%, përkundër Mitrovicës Jugore me 5.6%. Burrat kryesisht janë më pesimistë në raport me punësimin se gratë.





Figure 14. Punësimi në sektorin privat

Më lart, pamë që sektori privat është sektori i dytë në Mitrovicën Veriore dhe sektori i parë që gjeneron vende pune në Mitrovicën Jugore. Ndaj janë dy dallime thelbësore në perceptimet e qytetarëve. Rreth 44% e respondentëve nga Mitrovica Veriore mendojnë që punësimi në sektorin privat bëhet përmes njerëzve të njohur. Kundrejt të anketuarave nga Mitrovica Jugore, të cilët janë më optimistë për këtë sektor, ku 35.2% mendojnë se aftësitë dhe kompetenca janë të mjaftueshme për t'u punësuar në këtë sektor.





Figure 15. Preferenca për punësim në Kosovë apo në ndonjë shtet në Evropë

Situata në Mitrovicën Jugore dhe atë Veriore ndryshon kur vjen çështja të punësimi në të ardhmen. Gratë në Mitrovicën Jugore kanë tendencë të kërkojnë punë në Evropë më shumë se burrat (16.6%), por e kundërta vlen në Mitrovicën Veriore.

Kurse, gratë në Mitrovicën Veriore preferojnë të gjejnë një punë në Kosovë (17% e tyre). E kundërta vlen dhe për burrat në të dy komunat. Burrat në Mitrovicën Jugore kanë



tendencë më të madhe të kërkojnë punë në Kosovë, përkundër burrave në Mitrovicën Veriore që kanë tendencë më të lartë migrimi. 25% e tyre dëshirojnë të gjejnë punë në Evropë përkundër 12% të grave.

E kundërt me Mitrovicën Jugore është edhe vendosmëria për të ardhmen, pasi gratë janë më të pasigurta për të ardhmen e tyre.

### 3. BINDJET DHE QËNDRIMET

Stabiliteti në punën aktuale është po ashtu një çështje mjaft e rëndësishme, për ç'gjë u pyetën respondentët nga të dy komunat. Në lidhje me mundësinë që të jenë të papunë në 12 muajt e ardhshëm, një përqindje e madhe burrash nga Mitrovica Jugore (16.6%) u shprehën se nuk është aspak e mundshme. Kjo tregon nivel të lartë stabiliteti në punë te një përqindje e konsiderueshme e respondentëve burrash. Për dallim nga burrat, gratë në të njëjtën komunë nuk kanë të njëjtin stabilitet. 18.2% e tyre treguan që mundësia për të qenë e papunë në vitin e ardhshëm është disi e mundshme dhe 5.3% e tyre shumë e mundshme. Vetëm 4% u shprehën se nuk është aspak e mundshme për të humbur vendin e punës në vitin vijues.

Pra, diferenca mes burrave dhe grave që u shprehën se nuk është aspak e mundshme që të humbin vendin e punës është 12,6%, që flet më së miri për sigurinë e qëndrueshmërisë në vendin e punës.

Ndërkohë, për dallim nga Mitrovica Jugore, në Mitrovicën Veriore, situata duket të jetë ndryshe. Qëndrueshmëria në punësim për vitin pasues është e mjaft e lartë si për burrat dhe për gratë. 27% e burrave dhe 21% e grave besojnë që nuk do të humbin vendin e punës në 12 muajt e ardhshëm. Derisa mundësinë për të humbur vendin e punës e besojnë 13% e të anketuarve burra dhe 12% e të anketuarave gra.




Figure 16. Sa është e mundshme që në 12 muajt e ardhshëm të jeni i/e papunë dhe të kërkontë punë për të paktën 4 javë rresht?

Duke u nisur nga fakti që Kosova nuk ofron sigurim shëndetësor për të punësuarit, kujdesi mjekësor personal dhe familjar rëndon drejtpërdrejt në buxhetin familjar, dhe shpesh mund të neglizhohet. Rreth 26% dhe 17% e pjesëmarrësit burra në sondazh nga komuna

e Mitrovicës Jugore dhe asaj Veriore, respektivisht, tregojnë se mund të mos pranojnë kujdes mjekësor në 12 muajt në vijim. Ndërsa 18% e të anketuarave gra nga Mitrovica Veriore shprehin se aspak nuk është e mundshme që ato të mos pranojnë kujdes mjekësor dhe vetëm 2.4% nga Mitrovica Jugore kanë të njëjtin qëndrim. Kjo tregon një mospërputhje qëndrimesh për gratë në të dy komunat, pasi ato në Mitrovicën Veriore shprehin se nuk është e mundur që të mos pranojnë kujdes mjekësor, që mëton të jetë një realitet i kundërt me atë në Mitrovicën Jugore.




Figure 17. Sa është e mundshme që ju të mos merrni kujdesin mjekësor që ju nevojitet nëse sëmureni gjatë 12 muajve të ardhshëm

Se si e shohin qytetarët e Mitrovicës koston e pensioneve në Kosovë, është një çështje tjetër që u trajtua në anketim. Rreth 49% e të anketuarave nga Mitrovica Jugore mendojnë që Kosova do të jetë në gjendje të rrisë nivelin e pensioneve, të cilin pohim e besojnë vetëm 9% e të anketuarave nga Mitrovica Veriore. 40% e tyre u shprehën se niveli aktual i pensioneve është i përballueshëm për buxhetin e Kosovës.




Figure 18. Debatohet për koston e pensioneve në Kosovë. Sipas jush, cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë?

Një tjetër çështje tejet e rëndësishme që është trajtuar në këtë hulumtim është dhe perceptimi i qytetarëve rreth pamjaftueshmërisë së të ardhurave për të mbuluar nevojat bazike.

Një përqindje e madhe e qytetarëve nga Mitrovica Jugore (26.3%) vlerësojnë se në çdo 100 persona, më shumë se 50 persona nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar nevojat bazike. Për dallim nga ajo çfarë besojnë qytetarët në Mitrovicën Jugore, një përqindje jo e vogël e qytetarëve në Mitrovicën Veriore (23%), besojnë se vetëm 5-9 persona në 100 persona nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar nevojat bazike.

Gratë në mostër nga të dy rajonet shfaqin perspektivë më pozitive për këtë çështje.






Figure 19. Për çdo 100 persona në moshë pune, sa mendoni se nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar nevojat bazike?

Pushimi i lehonisë ka një rëndësi të veçantë dhe është një nga temat që kërkon vëmendje të veçantë, ndaj dhe është trajtuar në këtë hulumtim.

Gjithsesi, në lidhje me pushimin e lehonisë, një mospërputhje qëndrimesh vërehet në komunën Jugore dhe atë Veriore. Në Mitrovicën Jugore 68% e të anketuarve e konsiderojnë që gjatësia e pushimit të lehonisë është e përshtatshme. Vlen të theksohet se 26% e përgjigjeve vjen nga respondentet gra. Por, një mendim i tillë nuk është dhe në Mitrovicën Veriore. Aty, 41% e të anketuarve konsiderojnë që ky pushim është i shkurtër, dhe vërehet një ndryshim i vogël ndërmjet perceptimeve të të anketuarve gra dhe burra.

## Mitrovica Jugore



## Mitrovica Veriore




Figure 20. Sipas jush, pushimi i lehonisë në Kosovë është?

## 4. PËRCEPTIMET PËR SHTETIN DHE MIRËQENIEN

Në këtë hulumtim u trajtuan dhe perceptimet mbi shërbimet shëndetësore në institucionet publike, të ofruara nga institucionet kosovare gjatë 12 muajve të fundit dhe të cilat janë pranuar nga qytetarët e Mitrovicës Jugore dhe Veriore.

Një disbalanc i theksuar vërehet te pranimi i shërbimeve shëndetësore nga burrat në Mitrovica Jugore dhe ajo Veriore.

45.7% e respondentëve burra nga Mitrovica Jugore pohuan që kanë pranuar shërbime shëndetësore, gjersa 42% e respondentëve burra nga Mitrovica Veriore mohuan të kenë pranuar shërbime shëndetësore.

Në përgjithësi më pak gra respondente kanë pranuar shërbime shëndetësore në 12 muajt e fundit, 27.1% dhe 14%, respektivisht për Mitrovicën Jugore dhe atë Veriore.




Figure 21.A keni marrë ndonjë shërbim shëndetësor në institucionet publike gjatë 12 muajve të fundit?

Se sa janë të kënaqur me efikasitetin e shërbimeve publike shëndetësore të pranuar, nga respondentët shohim se 42% e burrave konsiderojnë shërbimet e pranuar deri diku dhe mesatarisht efikase, gjersa gratë kanë nivele më të ulëta.




Figure 22. Sa efikas mendoni se është shërbimi publik shëndetësor në Kosovë?

Mitrovica Jugore	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem deri diku	Pajtohem plotësisht
Shumica e njerëzve me të ardhura të ulëta marrin më pak ndihmë sesa u takon ligjërisht	9.3%	2.8%	10.9%	11.3%	57.9%
Shumica e njerëzve arrijnë të marrin ndihmë dhe shërbime që nuk u takojnë	9.3%	2.8%	9.7%	10.5%	60.7%
Në Kosovë nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për të ndihmuar të gjithë ata që kanë realisht nevojë	9.7%	2.4%	9.7%	9.3%	62.3%

Mitrovica Veriore	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem deri diku	Pajtohem plotësisht
Shumica e njerëzve me të ardhura të ulëta marrin më pak ndihmë sesa u takon ligjërisht	2.0%	11.0%	6.0%	7.0%	63.0%
Shumica e njerëzve arrijnë të marrin ndihmë dhe shërbime që nuk u takojnë	5.0%	10.0%	9.0%	6.0%	57.0%
Në Kosovë nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për të ndihmuar të gjithë ata që kanë realisht nevojë	17.0%	13.0%	8.0%	7.0%	36.0%

Figure 23. Perceptimet mbi mjetet financiare

Duke marrë parasysh problemet socio-ekonomike të qytetarëve në Kosovë, të anketuarit janë pyetur për lartësinë e mjaftueshme të pensionit mujor, i cili është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat bazë. 57% e respondentëve nga Mitrovica Jugore konsiderojnë që 201-300 Euro janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat, derisa 30% dhe 25% e



respondentëve nga komuna Veriore konsiderojnë kategorinë 301-400 Euro dhe 401-500 Euro , si një pension të denjë për të përmbushur nevojat.




Figure 24. Sipas jush, sa i lartë duhet të jetë një pension mujor për të mbuluar nevojat bazë

Shumë përfitime dhe shërbime publike paguhen përmes parave të mbledhura nga taksat. Kur u pyetën të anketuarit se nëse qeveria do të vihej para zgjedhjes që të rrisë taksat dhe të japë më shumë shërbime publike, 48.6% e respondentëve nga Mitrovica Jugore e përkrahën këtë pohim, kundrejt Mitrovicës Veriore, që u mbështet me vetëm 31% e të respondentëve. Ndërkohë, në pohimin se nëse qeveria do të vihej para zgjedhjes që të ulë taksat por të japë më pak shërbime publike, 26.3% e respondentëve nga Mitrovica Jugore dhe 17% e respondentëve nga Mitrovica Veriore e përkrahën. Vlen të theksohet se gati gjysma e të anketuarve nga Mitrovica Veriore nuk mbështetën asnjërën nga pohimet.




Figure 25. Qeveria dhe taksat

## 5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Studimi që është subjekt i këtij raporti në radhë të parë nxjerrë në pah dallimet, në disa raste, shumë të mëdha me të cilat karakterizohen dy komunat e Mitrovicës, që janë vetëm dy nga 38 komunat e vendit tonë. Përkundër afërsisë fizike, qytetarët e anketuar shfaqin pikëpamje, perceptime, dhe qëndrime shumë të ndryshme në krahasim me fqinjët e tyre nga komuna tjetër.

Në kontekstin e politikave sociale rajoni i Mitrovicës paraqet rast unik studimor, ku e tërë ekonomia e rajonit, që dikur ishte e ndërlidhur me industrinë e metalurgjisë dhe shërbimet për të, është transformuar në dy anët e lbrit përgjatë dy dekadave të fundit, për të marrë rrjedhë krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe duke prodhuar realitet të ndryshëm social. Rajone të tilla kemi edhe në vise të tjera të vendit, sidomos përgjatë kufijve të komunave me shumicë shqiptare dhe atyre serbe.

Duke qenë se qëllimi primar i politikave sociale dhe masave të tjera mbrojtëse për grupet më të cenueshme në shoqëri; edhe specifikat në të gjitha rajonet e vendit duhet të merren parasysh në mënyrë që edhe politikat të jenë gjithëpërfshirëse dhe adresojnë nevojat dhe prioritetet e qytetarëve që synojnë të ndihmojnë.

Një qëllim tjetër i politikave sociale është edhe rritja e kohezionit social dhe zvogëlimit të pabarazive në shoqëri, ato (politikat sociale) duhet të vihen në funksion të integritetit të një pjese të qytetarëve të Kosovës me etni serbe që ende refuzojnë të pranojnë Kosovën si shtetin e tyre. Grupet e cenueshme, sidomos në vendbanimet e banuara me shumicë serbe janë edhe më të cenueshme se grupet e njëjta që jetojnë në viset e banuara me shumicë shqiptare, pasi që tek ta peshon edhe aspekti i izolimit brenda vendit.

Në kontekstin lokal, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komunat kanë kompetenca të avancojnë politikat sociale për qytetarët e tyre përtej minimumit të garantuar me ligj për të gjithë qytetarët e vendit. Ato gjithashtu kanë kompetenca të zgjeruara në fushat zhvillim ekonomik lokal, e në fusha të ndërlidhura me punësimin dhe mirëqenien. Komunat duhet të jenë pro aktive në identifikimin e nevojave të sakta përmes matjeve reale dhe të njëjtat të tentojnë t'i adresojnë përmes politikave dhe programeve të tyre zhvillimore.

Aktualisht, dy komunat nuk kanë të sinkronizuar asnjë aspekt të funksionimit dhe planifikimit dhe veprojnë plotësisht ndaras nga njëra-tjetra. Kështu, shumë punë duplikohet, secila komunë është e pa-harmonizuar dhe ndërlidhur me pjesën tjetër të qytetit, si dhe prioritetet dhe pritjet e qytetarëve ndryshojnë në të dy anët e lbrit. Studimi aktual vetëm sa nxjerrë në pah diversitetin e madh brenda komuniteteve të vogla në mbarë vendin. Kjo shërben si një përkujtues për vendim-marrësit dhe hartuesit e politikave se vendimet e tyre duhet të jenë të informuara për nevojat e qytetarëve, si atyre shumicë ashtu edhe atyre pakicë, pasi që vetëm në këtë mënyrë ato do t'i shërbejnë qëllimeve për të cilat janë krijuar.

# SHTOJCA 1: RAPORTI I PËRGJITHSHËM STATISTIKOR:

## Mitrovica Jugore

MITROVICA JUGORE		
Komuna e origjinës/Fshati		%
Bajgorë		3.2%
Deçan		0.8%
Drenas		0.4%
Ferizaj		1.2%
Gjilan		0.4%
Kamenicë		0.4%
Kçiq i Madh		6.1%
Kçiq i Vogël		2.8%
Klinë		0.4%
Malishevë		0.8%
Mitrovicë		46.6%
Pejë		1.2%
Prishtinë		0.8%
Prizren		0.8%
Shipol		7.7%
Shupkoc		3.6%
Skenderaj		3.2%
Stantërg		2.0%
Vaganicë		5.3%
Vushtrri		3.2%
Zhabar i P.		8.9%
TOTAL		100%

A4.KOMUNA E VENDBANIMIT				
	Gjinia			Total
	Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
MITROVICA JUGORE	36.8%	61.5%	0.8%	99.2%
Vushtrri	0.8%	0.0%	0.0%	0.8%
Total	37.7%	61.5%	0.8%	100%

A9B A KENI PËRFUNDUAR NDONJË KUALIFIKIM/CERTIFIKIM PROFESIONAL ?					
Po, nga ofrues publik (QAP)					
MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
Po, nga ofrues publik (QAP)	Po				
		5.3%	11.7%	0.0%	17.0%
	Jo				
		32.0%	47.8%	0.8%	80.6%
	Pa përgjigje				
		0.4%	2.0%	0.0%	2.4%
Total					
		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

PO, NGA OFRUES PRIVAT/OJQ (ME PAGESË)					
MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjëm	
Po, nga ofrues privat/OJQ (me pagesë)	Po	6.1%	7.7%	0.0%	13.8%
	Jo	31.2%	51.8%	0.8%	83.8%
	Pa përgjigje	0.4%	2.0%	0.0%	2.4%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

PO, NGA OFRUES PRIVAT/OJQ (PA PAGESË)					
MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjëm	
Po, nga ofrues privat/OJQ (pa pagesë)	Po	12.6%	11.3%	0.0%	23.9%
	Jo	24.7%	48.2%	0.8%	73.7%
	Pa përgjigje	0.4%	2.0%	0.0%	2.4%
Totali		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

JO, NUK KAM NDJEKUR ASNJË PROGRAM KUALIFIKIMI/CERTIFIKIMI					
MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjëm	
Jo, nuk kam ndjekur asnjë program kualifikimi/certifikimi	Po	19.4%	35.6%	0.8%	55.9%
	Jo	17.8%	23.9%	0.0%	41.7%
	Pa përgjigje	0.4%	1.6%	0.0%	2.0%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

A10. CILI ËSHTË STATUSI JUAJ I TANISHËM I PUNËSIMIT?					
MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjëm	
	I/E papunë – afat-gjatë	14.6%	12.6%	0.0%	27.1%
	I/E papunë – afat-shkurtër	1.2%	2.4%	0.0%	3.6%
	I/E vetëpunësuar	2.4%	9.3%	0.0%	11.7%
	Punë sezonale	0.8%	1.6%	0.8%	3.2%
	I/E punësuar – përkohësisht	4.9%	6.1%	0.0%	10.9%
	I/E punësuar – afatgjatë	8.1%	19.8%	0.0%	27.9%
	I/E punësuar – me kohë të pjesshme	0.4%	0.8%	0.0%	1.2%
	Student	2.0%	4.0%	0.0%	6.1%
	I/E pensionuar	2.8%	4.0%	0.0%	6.9%
	PP	0.4%	0.8%	0.0%	1.2%
Totali		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

<b>A12.(NËSE JENI I/E PUNËSUAR) SA KOHË KENI QENË I/E PUNËSUAR NË PUNËN TUAJ TË TANISHME?</b>					
MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
	Më pak se 6 muaj	2.0%	4.0%	0.4%	6.5%
	6 muaj - 1 vit	3.2%	4.0%		7.3%
	1 vit - 2 vite	3.2%	3.2%	0.4%	6.9%
	2 vite - 5 vite	2.4%	5.7%		8.1%
	Më shumë se 5 vite	6.9%	17.8%		24.7%
	PP	19.8%	26.7%		46.6%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

<b>A13.(NËSE JENI I/E PUNËSUAR) SI E KENI GJETUR VENDIN E PUNËS?</b>					
MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
	Përmes zyrës publike të punësimit (MPMS)	4.0%	2.8%		6.9%
	Përmes zyrës publike të punësimit (me ndërmjetësimin e ndonjë projekti të donatorëve)	1.6%			1.6%
	Përmes një agjencie private të punësimit	1.2%	2.0%		3.2%
	Përmes aplikimit të drejtëpërdrejtë të punëdhënësi	4.5%	10.9%		15.4%
	Përmes shokëve/miqve	2.4%	8.1%		10.5%
	Përmes vendosjes të shpalljeve në gazetë/a	2.4%	2.8%	0.4%	5.7%
	Përmes intervistimit		1.6%		1.6%
	Të tjera	0.8%	3.6%		4.5%
	PP	20.6%	29.6%	0.4%	50.4%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

<b>A14.NËSE JENI I/E PUNËSUAR, A KENI KONTRATË TË RREGULLT (A JU PAGUHEN KONTRIBUTET PENSIONALE)?</b>					
MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
	Jam i/e punësuar me kontratë të rregullt dhe më paguhen kontributet	13.8%	18.2%		32.0%
	Jam i/e punësuar me kontratë, por pagën e pranoj pjesërisht me para në dorë(kesh)	1.2%	4.9%		6.1%
	Jam i/e punësuar me kontratë por pagën e pranoj të plotë me para në dorë(kesh)		2.4%		2.4%
	Jam i/e punësuar pa kontratë	1.2%	6.5%	0.4%	8.1%
	Preferoj të mos përgjigjem	21.5%	29.5%	0.4%	51.4%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**A15.(NËSE NUK JENI I/E PUNËSUAR) SA KOHË JENI I/E PAPUNË?**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjëm	
	Më pak se 6 muaj	1.6%	1.6%		3.2%
	6 muaj - 1 vit	1.2%	3.2%		4.5%
	1 vit - 2 vite	0.4%	0.8%		1.2%
	2 vite - 5 vite	0.8%	0.8%		1.6%
	Më shumë se 5 vite	12.6%	10.5%		23.1%
	Pa përgjegje	21.1%	44.5%	0.8%	66.4%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**A17.(NËSE NUK JENI I/E PUNËSUAR) NË SA VENDE KENI KËRKUAR/APLIKUAR PËR PUNË GJATË 12 MUAJVE TË FUNDIT?**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjëm	
	Asnjë pozitë/punë	7.7%	8.5%		16.2%
	1-5 pozita/punë	6.5%	4.5%		10.9%
	6-10 pozita/punë	1.2%	1.6%		2.8%
	11-20 pozita/punë		1.2%		1.2%
	Më shumë se 20 pozita/punë	0.8%	2.4%		3.2%
	Pa përgjegje	21.5%	43.3%	0.8%	65.6%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**A.18(NËSE NUK JENI I/E PUNËSUAR) ÇFARË PUNE DO TË DËSHIRONIT TË KISHIT/BËNIT?**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjëm	
	I/E vetëpunësuar (biznes personal)	8.1%	10.1%		18.2%
	I/E punësuar me kohë të plotë	3.6%	6.5%		10.1%
	I/E punësuar me kohë të pjesshme	2.4%	1.6%		4.0%
	I/E punësuar afat-shkurtër	0.4%	0.4%		0.8%
	Të tjera	0.4%			0.4%
	Pa përgjegje	22.7%	42.9%	0.8%	66.4%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**A19. NËSE NUK JENI I/E PUNËSUAR) A JENI I/E REGJISTRUAR NË ZYRAT E PUNËSIMIT?**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjëm	
	Po	6.1%	9.7%		15.8%
	Jo	6.5%	4.9%		11.3%
	Nuk kam dëgjuar për to	4.0%	3.6%		7.7%
	Pa përgjegje	21.1%	43.3%	0.8%	65.2%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**A23.1.NË 12 MUAJT E FUNDIT A KENI BËRË NDONJË NGA VEPRIMET E MËPOSHTME?  
KAM VIZITUAR QENDRËN E PUNËSIMIT**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
Po		5.7%	7.7%		13.4%
Jo		10.9%	10.9%		21.9%
Pa përgjegje		21.1%	42.9%	0.8%	64.8%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**A23.2.KAM KONTAKTUAR ME AGJENCI PRIVATE TË PUNËSIMIT**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
Po		5.3%	6.1%		11.3%
Jo		11.3%	12.6%		23.9%
Pa përgjegje		21.1%	42.9%	0.8%	64.8%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**A23.3.KAM APLIKUAR DREJTËPËRDREJTË TE PUNËDHËNËSI**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
Po		7.7%	8.5%		16.2%
Jo		8.9%	10.1%		19.0%
Pa përgjegje		21.1%	42.9%	0.8%	64.8%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**A23.4.KAM KËRKUAR NGA MIQ, TË AFËRM, SINDIKATA**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
Po		6.9%	9.7%		16.6%
Jo		9.7%	8.9%		18.6%
Pa përgjegje		21.1%	42.9%	0.8%	64.8%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**A23.5.U JAM PËRGJIGJUR NJOFTIMEVE NË GAZETA**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
Po		5.3%	5.7%		10.9%
Jo		11.3%	13.0%		24.3%
Pa përgjegje		21.1%	42.9%	0.8%	64.8%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**A24A.NËSE NUK JENI I/E PUNËSUAR) NËSE DO TË GJENIT PUNË, A MUND TË FILLONI  
MENJËHERË/SHPEJTË?**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
Po		14.6%	15.4%		30.0%
Jo		2.0%	2.4%		4.5%
Pa përgjegje		21.1%	43.7%	0.8%	65.6%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**A24A1.NËSE NUK JENI I/E PUNËSUAR) NËSE DO TË GJENIT PUNË, A MUND TË FILLONI MENJËHERË/SHPEJTË?**

Nëse jo, pse?				
MITROVICA JUGORE	Gjinia			Total
	Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
Duhet të mbaroj shkollimin/trajnimin	0.8%	1.6%		2.4%
Për shkak të përgjegjësive personale/familjare	1.2%	0.4%		1.6%
Sëmundje ose paaftësi		0.8%		0.8%
Pa përgjegje	35.6%	58.7%	0.8%	95.1%
Total	37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**B1.1 USHQIME DHE MATERIALE SHPENZUESE (HIGJIENË, SHKOLLA E MESME, AMVISËRI)**

MITROVICA VERIORE	N	%
0	1	1.0
20	1	1.0
30	17	17.0
40	30	30.0
50	32	32.0
60	13	13.0
70	5	5.0
80	1	1.0
Total	100	100.0

**B1.2 SHËRBIME PUBLIKE**

MITROVICA JUGORE	N	%
0	14	2.6
2	4	0.7
5	13	2.4
8	3	0.6
10	99	18.3
15	22	4.1
20	69	12.7
25	2	0.4
30	19	3.5
70	1	0.2
Total	246	100.0

**B1.3 VESHJE DHE GJËRA TJERA PERSONALE**

MITROVICA JUGORE	N	%
0	42	7.7
1	2	.4
2	6	1.1
5	47	8.7
10	85	15.7
12	1	.2
15	7	1.3
20	49	9.0
25	3	.6



	30	4	.7
	40	1	.2
Total		247	100.0

<b>B1.4 BLERJE KAPITALE DHE/OSE KURSIMET (MAKINA, PATUNDSHMËRI)</b>			
MITROVICA JUGORE		N	%
	0	130	24.0
	1	3	.6
	2	4	.7
	5	32	5.9
	10	56	10.3
	20	20	3.7
	25	1	.2
	30	1	.2
Total		247	100.0

<b>B1.5 REKREACIONE DHE UDHËTIME</b>			
MITROVICA JUGORE		N	%
	0	72	13.3
	1	1	.2
	2	5	.9
	4	2	.4
	5	45	8.3
	10	90	16.6
	15	5	.9
	20	25	4.6
	30	1	.2
Total		246	100.0

<b>B2 JU LUTEM LISTONI VENDET QË KENI VIZITUAR GJATË TRE VITEVE TË FUNDIT (MË SHUMË SË NË PËRGGJIGJE)</b>			
MITROVICA JUGORE		N	%
Shqipëri		211	38.9%
Maqedoni e Veriut		49	9.0%
Serbi		18	3.3%
Mal I Zi		58	10.7%
Turqi		31	5.7%
Kroaci		8	1.5%
Bullgari		4	0.7%
Vendet evropiane të zonës Schengen		20	3.7%
Vendet evropiane jashtë zonës Schengen		2	0.4%
SHBA dhe Kanada		1	0.2%
Total		402	100%

<b>B3.1 HANI NË RESTORANTE OSE GJETIU</b>			
MITROVICA JUGORE		N	%
Asnjëherë		44	8.1
Disa herë në vit		90	16.6
Disa herë në muaj		89	16.4
Disa herë në javë		19	3.5
Çdo ditë		5	.9
Total		247	100.0

**B3.2 DILNI NË MBRËMJE PËR ARGËTIM NË KAFITERI DHE BARE**

<b>B3.2 DILNI NË MBRËMJE PËR ARGËTIM NË KAFITERI DHE BARE</b>			
<i>MITROVICA JUGORE</i>		N	%
Asnjëherë		40	7.4
Disa herë në vit		72	13.3
Disa herë në muaj		82	15.1
Disa herë në javë		40	7.4
Çdo ditë		12	2.2
Nuk e di /Ref		1	.2
Total		247	<b>100.0</b>

**B3.3 SHKONI NË KINEMA**

<b>B3.3 SHKONI NË KINEMA</b>			
<i>MITROVICA JUGORE</i>		N	%
Asnjëherë		126	23.2
Disa herë në vit		92	17.0
Disa herë në muaj		23	4.2
Disa herë në javë		2	.4
Çdo ditë		1	.2
Nuk e di /Ref		1	.2
Pa përgjigje		2	.4
Total		247	100.0

**B3.4 SHKONI NË TEATËR**

<b>B3.4 SHKONI NË TEATËR</b>			
<i>MITROVICA JUGORE</i>		N	%
Asnjëherë		142	26.2
Disa herë në vit		83	15.3
Disa herë në muaj		16	3.0
Disa herë në javë		2	.4
Çdo ditë		1	.2
Nuk e di /Ref		1	.2
Pa përgjigje		2	.4
Total		247	<b>100.0</b>

**B3.5 SHKONI NË PALESTËR**

<b>B3.5 SHKONI NË PALESTËR</b>			
<i>MITROVICA JUGORE</i>		N	%
Asnjëherë		121	22.3
Disa herë në vit		83	15.3
Disa herë në muaj		21	3.9
Disa herë në javë		8	1.5
Çdo ditë		11	2.0
Nuk e di /Ref		2	.4
Pa përgjigje		1	.2
Total		247	<b>100.0</b>

**B3.6 KONCERT OSE EKSPOZITË**

<b>B3.6 KONCERT OSE EKSPOZITË</b>			
<i>MITROVICA JUGORE</i>		N	%
Asnjëherë		147	27.1
Disa herë në vit		79	14.6
Disa herë në muaj		14	2.6
Disa herë në javë		2	.4
Pa përgjigje		5	.9
Total		247	100.0

**B3.7 NGJARJE SPORTIVE**

<i>MITROVICA JUGORE</i>	N	%
Asnjëherë	118	21.8
Disa herë në vit	96	17.7
Disa herë në muaj	23	4.2
Disa herë në javë	2	.4
Çdo ditë	2	.4
Nuk e di /Ref	1	.2
Pa përgjigje	5	.9
Total	247	100.0

**B3.8 UDHËTIME JASHTË VENDIT**

<i>MITROVICA JUGORE</i>	N	%
Asnjëherë	62	11.4
Disa herë në vit	149	27.5
Disa herë në muaj	20	3.7
Disa herë në javë	2	.4
Çdo ditë	2	.4
Nuk e di /Ref	3	.6
Pa përgjigje	9	1.7
Total	247	100.0

**B3.9 BLINI NJË DHURATË PËR VETE OSE TË AFËRMIT**

<i>MITROVICA JUGORE</i>	N	%
Asnjëherë	46	8.5
Disa herë në vit	143	26.4
Disa herë në muaj	39	7.2
Disa herë në javë	5	.9
Çdo ditë	2	.4
Nuk e di /Ref	3	.6
Pa përgjigje	9	1.7
Total	247	100.0

**B3.10 SHKONI NË PUSHIME**

<i>MITROVICA JUGORE</i>	N	%
Asnjëherë	42	7.7
Disa herë në vit	172	31.7
Disa herë në muaj	16	3.0
Disa herë në javë	4	.7
Çdo ditë	2	.4
Nuk e di /Ref	1	.2
Pa përgjigje	10	1.9
Total	247	100.0

**B3.11 KRYENI ANALIZA MJEKËSORE ME OSE PA SHKAS**

<i>MITROVICA JUGORE</i>	N	%
Asnjëherë	41	7.6
Disa herë në vit	157	29.0
Disa herë në muaj	23	4.2
Disa herë në javë	6	1.1
Çdo ditë	4	.7
Nuk e di /Ref	8	1.5
Pa përgjigje	8	1.5
Total	247	100.0

**B4 SA ËSHTË E MUNDSHME QË NË 12 MUAJT E ARDHSHËM TË JENI I/E PAPUNË DHE TË KËRKONI PUNË PËR TË PAKTËN 4 JAVË RRESHT?**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
	Aspak e mundshme	4.0%	16.6%		20.6%
	Disi e mundshme	18.2%	23.1%	0.4%	41.7%
	Shumë e mundshme	5.3%	8.5%	0.4%	14.2%
	Nuk e di	4.9%	5.7%		10.5%
	Pa përgjigje	5.3%	7.7%		13.0%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**B5 SA ËSHTË E MUNDSHME QË NË 12 MUAJT E ARDHSHËM DO T'JU DUHET TË SHKURTONI ORARIN NË PUNËN E PAGUAR PËR T'U KUJDESUR PËR ANËTARËT E TJERË TË FAMILJES?**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
	Aspak e mundshme	8.1%	19.0%		27.1%
	Disi e mundshme	12.1%	16.6%		28.7%
	Shumë e mundshme	2.8%	7.3%	0.4%	10.5%
	Nuk e di	7.7%	8.9%		16.6%
	Pa përgjigje	6.9%	9.7%	0.4%	17.0%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**B6 SA ËSHTË E MUNDSHME QË GJATË 12 MUAJVE TË ARDHSHËM TË KETË PERIUDHA KUR NUK DO TË KENI TË ARDHURA TË MJAFTUESHME PËR TË MBULUAR NEVOJAT THEMELORE TË FAMILJES SUAJ?**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
	Aspak e mundshme	5.7%	14.6%	0.4%	20.6%
	Disi e mundshme	17.4%	23.5%		40.9%
	Shumë e mundshme	6.5%	9.7%	0.4%	16.6%
	Nuk e di	4.9%	6.1%		10.9%
	Pa përgjigje	3.2%	7.7%		10.9%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**B7 SA ËSHTË E MUNDSHME QË JU TË MOS MERRNI KUJDESIN MJEKËSOR QË JU NEVOJITET NËSE SËMURENI GJATË 12 MUAJVE TË ARDHSHËM?**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
	Aspak e mundshme	2.4%	9.3%	0.4%	12.1%
	Disi e mundshme	19.8%	25.9%		45.7%
	Shumë e mundshme	6.1%	9.3%	0.4%	15.8%
	Nuk e di	6.5%	9.7%		16.2%
	Pa përgjigje	2.8%	7.3%		10.1%
Total		37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**B8 A MENDONI SE NDIHMA SOCIALE NË KOSOVË PËRFUNDON TE FAMILJET QË KANË MË SË SHUMTI NEVOJË?**

MITROVICA JUGORE		Gjinia			Total
		Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	

Aspak dakord	3.2%	6.9%	0.4%	10.5%
Jo dakord	13.4%	27.1%		40.5%
Neutral	8.9%	13.0%		21.9%
Dakord	8.9%	8.1%		17.0%
Shumë dakord	2.8%	1.6%		4.5%
Nuk e di	0.4%	4.5%	0.4%	5.3%
Pa përgjigje		0.4%		0.4%
Total	37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**B9 KOHËT E FUNDIT ËSHTË DEBATUAR SHUMË PËR KOSTON QË SHTETI MBART PËR SHËRBIMET MJEKËSORE PUBLIKE NË KOSOVË. SIPAS JUSH, CILI NGA POHIMET E MËPOSHTME ËSHTË I VËRTETË? NË TË ARDHMEN E AFËRT:**

MITROVICA JUGORE	Gjinia			Total
	Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjëm	
Kosova nuk do të jetë në gjendje të përballojë koston e nivelit aktual të shërbimeve mjekësore publike	3.6%	7.3%		10.9%
Kosova do të jetë në gjendje të përballojë koston aktuale të shërbimeve mjekësore pub. por jo ta përmirësojë atë.	18.6%	18.6%	0.4%	37.7%
Kosova do të jetë në gjendje ta përmirësojë nivelin e shërbimeve mjekësore publike	14.6%	29.6%		44.1%
Nuk e di	0.8%	6.1%	0.4%	7.3%
Total	37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**B10 DEBATOHEM EDHE PËR KOSTON E PENSIONEVE NË KOSOVË. SIPAS JUSH, CILI NGA POHIMET E MËPOSHTME ËSHTË I VËRTETË ? NË TË ARDHMEN E AFËRT:**

MITROVICA JUGORE	Gjinia			Total
	Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjëm	
Kosova nuk do të jetë në gjendje të përballojë nivelin aktual të pensioneve	5.7%	9.7%	0.4%	15.8%
Kosova do të jetë në gjendje të përballojë nivelin aktual të pensioneve	13.4%	10.1%		23.5%
Kosova do të jetë në gjendje të rrisë nivelin e pensioneve	15.8%	32.8%		48.6%
Nuk e di	2.8%	8.9%	0.4%	12.1%
Total	37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**B11 PËR ÇDO 100 PERSONA NË MOSHË PUNE NË KOSOVË, SA MENDONI SE JANË TË PAPUNË?**

MITROVICA JUGORE	Gjinia			Total
	Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjëm	
0-4		0.4%		0.4%
5-9		0.8%		0.8%
10-14		0.8%		0.8%
15-19	0.8%	1.2%		2.0%
20-24	1.6%	2.0%		3.6%
25-29	0.4%	2.0%		2.4%
30-34	1.6%	2.0%		3.6%
35-39	1.2%	6.1%		7.3%

40-44	5.3%	4.0%		9.3%
45-49	10.1%	12.6%		22.7%
50 ose më shumë	15.8%	27.1%	0.4%	43.3%
Nuk e di	0.8%	2.0%	0.4%	3.2%
Pa përgjigje		0.4%		0.4%
Total	37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**B12 SA PREJ TYRE APLIKOJNË NË MËNYRË AKTIVE PËR PUNË? NËSE NUK JENI TË SIGURT, JEPNI VLERËSIMIN TUAJ TË PËRAFËRT (ZGJIDHNI MIDIS ALTERNATIVAVE)**

MITROVICA JUGORE	Gjinia			Total
	Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
0-4		0.8%		0.8%
10-14	1.2%	2.0%		3.2%
15-19	0.4%	2.8%		3.2%
20-24	1.6%	1.6%		3.2%
25-29	0.8%	1.2%		2.0%
30-34	2.0%	3.6%		5.7%
35-39	2.8%	4.5%		7.3%
40-44	4.9%	4.5%	0.4%	9.7%
45-49	6.9%	10.1%		17.0%
50 ose më shumë	13.0%	21.1%		34.0%
Nuk e di	3.6%	8.9%	0.4%	12.1%
Pa përgjigje	0.4%	0.4%		0.8%
Total	37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**B13 PËR ÇDO 100 PERSONA NË MOSHË PUNE, SA MENDONI SE NUK KANË TË ARDHURA TË MJAFTUESHME PËR TË MBULUAR NEVOJAT BAZIKE?**

MITROVICA JUGORE	Gjinia			Total
	Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
0-4	1.2%	2.4%		3.6%
5-9	0.4%	2.4%		2.8%
10-14	1.2%	2.4%		3.6%
15-19	1.6%	2.8%		4.5%
20-24	1.2%	1.2%		2.4%
25-29	1.6%			1.6%
30-34	1.6%	2.0%		3.6%
35-39	3.2%	5.7%	0.4%	9.3%
40-44	4.0%	9.3%		13.4%
45-49	7.7%	8.5%		16.2%
50 ose më shumë	9.7%	16.6%		26.3%
Nuk e di	4.0%	7.7%	0.4%	12.1%
Pa përgjigje		0.4%		0.4%
Total	37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

**B14 SIPAS JUSH, CILA PREJ KËTYRE KATEGORIVE TË QYTETARËVE PËRFITON AKTUALISHT MBËSHËTJETE FINANCIARE NË KOSOVË(MUND TË ZGJIDHNI MË SHUMË SE NJË PËRGJIGJE)**

MITROVICA JUGORE	N	%
Veteranët e luftës	220	40.6
Prindërit/të afërmit e viktimave të luftës	118	21.8
Viktimat e përdhunimit	95	17.5
Familjet e të zhdukurve (të humburve)	113	20.8
Fëmijët pa përkujdesje prindërore	93	17.2
Minoritetet	37	6.8
Pensionistët	114	21.0

Punëkërkuessit	37	6.8
Të varfërit	110	20.3
Nënat vetëmbajtëse	68	12.5
Total	542	100%

**B15 SIPAS JUSH, A KA NDONJË KATEGORI QË DUHET SHTUAR NË LISTËN E ATYRE QË MARRIN MBËSHËTETJE FINANCIARE?**

MITROVICA JUGORE	N	%
Pa përgjigje	154	28.4
Amviset	14	2.6
Diabetikët	3	.6
Fëmijët	3	.6
Fëmijët deri 18 vjet	1	.2
Fëmijet e sëmure	1	.2
Fëmijet me PAK	2	.4
Invalidët	2	.4
Mosha 40-65	1	.2
Nënat vetëushqyese	6	1.1
Nënat vetëushqyese, studenta	4	.8
Njerëzit pa përkujdesje	1	.2
P.A.K	3	.6
P.me dializë	1	.2
P.me zhvillim të ngadalsuar	1	.2
Pacientët me kancer	1	.2
Pensionistët	9	1.7
Punëkërkuessit	2	.4
Studentët	21	3.9
Të papunët	7	1.3
Të sëmuret	4	.7
Viktimat e Përdhunimit	6	1.1
Total	247	100.0

**B16 SIPAS JUSH, A KA NDONJË KATEGORI QË DUHET LARGUAR NGA LISTA E ATYRE QË MARRIN MBËSHËTETJE FINANCIARE?**

MITROVICA JUGORE	N	%
Pa përgjigje	228	42.1
Amviset	1	.2
Minoritetet	5	.9
Pensionistët	1	.2
Punëkërkuessit	1	.2
Të varfërit	1	.2
Veteranët e rrejshëm	10	1.9
Total	247	100.0

**B17 SIPAS JUSH, PUSHIMI I LEHONISË NË KOSOVË ËSHTË?**

MITROVICA JUGORE	Gjinia			Total
	Femër	Mashkull	Preferoj mos të përgjigjem	
Shumë i shkurtër	1.6%	6.1%		7.7%
I shkurtër	9.7%	10.9%		20.6%
I përshtatshëm	25.9%	42.1%	0.8%	68.8%
I gjatë		0.8%		0.8%
Shumë i gjatë	0.4%	0.8%		1.2%
Pa përgjigje		0.8%		0.8%
Total	37.7%	61.5%	0.8%	100.0%

<b>B18 SIPAS JUSH SA I GJATË DUHET TË JETË PUSHIMI I LEHONISË NË KOSOVË?</b>		
MITROVICA JUGORE	N	%
1 vit	129	23,8
15 muaj	1	.2
16 muaj	1	.2
18 muaj	5	.9
2 vite	47	8,7
3 muaj	1	.2
3 vite	9	1,7
4 vite	1	.2
6 muaj	8	1,5
6-12muaj	1	.2
8 muaj	1	.2
Pa përgjigje	43	7,9
Total	247	100,0

<b>B19.1 DALLIMET E MËDHA NË TË ARDHURAT E NJERËZVE JANË TË PRANUESHME SEPSE SHPËRBLEJNË DALLIMET NË TALENT DHE PËRPEKJE</b>		
MITROVICA JUGORE	N	%
Nuk pajtohem aspak	109	20,1
Nuk pajtohem	27	5
Neutral	24	4,4
Pajtohem deri diku	16	3
Pajtohem plotësisht	57	10,5
Nuk e di	11	2
Pa përgjigje	3	0,6
Total	247	100

<b>B19.2 QË NJË SHOQËRI TË QUHET E DREJTË, DALLIMET NË STANDARDIN E JETESËS MIDIS NJERËZVE DUHET TË JENË TË VOGLA</b>		
MITROVICA JUGORE	N	%
Nuk pajtohem aspak	11	2
Nuk pajtohem	16	3
Neutral	24	4,4
Pajtohem deri diku	25	4,6
Pajtohem plotësisht	167	30,8
Nuk e di	1	0,2
Pa përgjigje	3	0,6
Total	247	100

<b>19.3 SHOQËRIA DHE SHTETI DUHET TË KUJDESEN PËR GRUPET PA MBËSHTETJE</b>		
MITROVICA JUGORE	N	%
Nuk pajtohem aspak	7	1,3
Nuk pajtohem	13	2,4
Neutral	15	2,8
